



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Kamëz, më 27.11.2024

**MODIFIKIM / SHTOJCË
TË GJITHË OPERATORËVE EKONOMIKË TË INTERESUAR**

Lënda: “Modifikimi i dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt:
Rikonstruksion i Rrugës”Nënë Tereza”Laknas

Për dijeni: Të gjithë operatorëve të mundshëm ekonomikë që kanë tërhequr në rrugë elektronike dokumentacionin për procedurën me Nr.REF-27514-10-31-2024, me objekt:
Rikonstruksion i Rrugës”Nënë Tereza”Laknas

Në mbështetje të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, nisur nga rekomandimet e bera nga Agjencia e Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktor vendosi të bëjë ndryshime në dokumentat e tenderit.

Njësia e Prokurimit bazuar në ligjin Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, neni 75 pika 2 dhe 3 në të cilin citohet: “2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce.

1. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimin të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor **mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave.**
2. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimin të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën **7 ditë** për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës”, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit me

objekt: **Rikonstruksion i Rrugës "Nënë Tereza" Laknas**, me Nr.REF-27514-10-31-2024, si më poshtë vijon:

1. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika **2.3.6**.

ISHTE:

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, **te kete te pakten 10 vite eksperience** dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).

BEHET

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).

2. Në pjesën e specifikimeve teknike bashkelidhur te DT.

- **A.K. do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standartit shqiptar SSH/UNI/EN/CEI, mbi komformitetin e standartit european dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit te akredituar në Republikën e Shqipërisë.**

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 75 pika 1, të ligjit Nr.162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, vendosi **të mos zgjasë afatin kohor** për dorëzimin e ofertës. Njësia e Prokurimit njofton të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: *Rikonstruktion i Rrugës ”Nënë Tereza”Laknas,* është si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **10.12.2024** Ora **10: ⁰⁰**

Vendi: www.app.gov.al. **Bashkia Kamëz**

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **10.12.2024** Ora **10: ⁰⁰**

Vendi: www.app.gov.al. **Bashkia Kamëz**

NJËSIA E PROKURIMIT